



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi në parim i projektligjit “Për shtetësinë”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Edmond Rrushi, Artemis Dralo, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Alban Zeneli, Lefter Maliqi, Luan Harusha, Arben Elezi, Anduel Xhindi, Elena Xhina, Ylli Shehu dhe Spartak Braho

Mungojnë:

Xhemal Qefalia, Myslim Murrizi dhe Paulin Sterkaj

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Pablo Zapata- Ambasador i UNHCR-së

Sokol Sheti – Drejtor i Drejtorisë së Shtetësisë

Alma Mehmeti- Shefe sektori në Drejtorinë Juridike

Brian Williams- Kordinatori rezident i UNHCR-së

Artur Marku- Përfaqësues i UNHCR-së

Kristina Folkelius- Përfaqësuese e UNHCR-së

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë.

Projektligji që prezantojmë lidhet me shtetësinë shqiptare. Sot është një mbledhje e veçantë, sepse kemi edhe prezencën e disa përfaqësuesve të një organizate të rëndësishme ndërkombëtare.

Të ftuar për të prezantuar projektligjin kemi zëvendësministren e Brendshme, zonjën Rovenë Voda, që ka kryesuar grupin e punës, i cili ka punuar për projektligjin, zotin Sokol Sheti, që është drejtor i Shtetësisë, dhe zonjën Alma Mehmeti, që është shefe e sektori në Drejtorinë Juridike.

Gjithashtu, më lejoni, që në emër të komisionit, t’iu uroj mirëseardhjen zotit Brian Williams koordinatori rezident i UNHCR-së, zotit Pablo Zapata ambasador i UNHCR-së, zotit Artur Marku dhe zonjës Kristina Folkelius, që janë përfaqësues të UNHCR-së.

Relatore është zonja Elona Gjebrea.

Kolegë, meqenëse kemi pasur rast të kemi një takim formal me zotin Zapata, në krah keni një tabelë të projektligjit të sjellë nga Ministria e Brendshme së bashku me propozimet që janë bërë nga UNHCR-ja.

Meqenëse në kalendarin e Kuvendit është parashikuar që ky projektligj të votohet në Kuvendin e Shqipërisë më 14 nëntor, unë besoj se kemi kohë të mjaftueshme në dispozicion për të mundësuar një përmbajtje sa më adekuate, sa më të përshtatshme të një ligji që, në fakt, i kishte ardhur koha ta kishim të ri, për të reflektuar të gjitha ndryshimet e ndodhura në një kohë të gjatë.

Fjalën e ka zonja Voda për të bërë prezantimin e projektligjit.

Rovena Voda –Faleminderit!

Sot jemi këtu për të prezantuar projektligjin për shtetësinë, i cili ka impakt shumë të madh për qytetarët e Shqipërisë, por edhe për ata që janë jashtë. Ky ligj i përket legjislacionit të brendshëm. Nuk është një ligj që, ashtu sikurse ligjet e tjera, tenton të bëjë një përafrim me legjislacione të vendeve të tjera të BE-së, lindi si një nevojë duke qenë se gjatë zbatimit të ligjit të vjetër të vitit 1998 “Për shtetësinë” ka pasur problematika të ndryshme. Pra, lindi si nevojë rishikimi i këtij ligji. Në fillim u nisëm për të pasur një ndryshim të ligjit për shtetësinë, por, duke

parë se gjatë hartimit të tij se dolën problematika nga më të ndryshmet, u propozua që të vinte si ligj i ri, i parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Brendshme.

Mendojmë se ligji është paraqitur brenda afatit të programit analitik të akteve të Këshillit të Ministrave. Pritëm të merrnim komente edhe nga institucione të ndryshme, përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare. Kemi pasur kontakte me disa prej tyre, ashtu sikurse edhe me UNHCR-në. Për herë të parë ky ligj përfshin edhe RIA-n.

Zonja Felaj, duke qenë se kenë qenë ministre e Shtetit, e dini mirë punën e madhe që është bërë atëherë për të futur Shqipërinë në vendet që do të kishin një legjislacion, ku do të bëhej edhe RIA. Ja sot bëmë të mundur paraqitjen e këtij ligji, i cili përfshin një lloj analize të një RIA-je të lehtë.

Në përgjithësi unë do ta vlerësoja si një ligj të mirë, sepse zgjidh një sërë problematikash që lidhen me mënyrat e fitimit të shtetësisë shqiptare. Për shembull, në ligjin e mëparshëm mungonte fitimi i shtetësisë nëpërmjet origjinës, por bëhej nëpërmjet një VKM-je, që, në fakt, nuk ishte e rregulluar apo nuk kishte autorizimin e duhur ligjor, ndërsa sot kemi mundësi që fitimin e shtetësisë nëpërmjet origjinës ta kemi si një nga format e shtetësisë të parashikuar në ligj.

Jemi bazuar në legjislacionin italian duke zbatuar parimin e njohur të lidhjes së gjakut të paraardhësit deri në shkallën e tretë, por mbi bazë shtetësie, jo mbi bazë etnie, pra duke lidhur origjinën mbi bazën e shtetësisë.

Po kështu jemi munduar të rregullojmë regjistrimin e fëmijëve të lindur nga prindër shqiptarë, që shpeshherë kanë hasur pengesa në regjistrimin e tyre, duke rrezikuar të mos marrin shtetësinë. Ne jemi munduar ta përforcojmë këtë parim, pra të fitimit të shtetësisë nëpërmjet nenit 5 të këtij ligj, duke garantuar një normë kushtetuese, pra që çdo fëmijë, që ka të paktën njërin prind shqiptar, ta fitojë shtetësinë, por duke i dhënë një garanci më shumë që kjo e drejtë nuk parashkruhet edhe nëse fëmija mbush moshën 18 vjeç, duke u siguruar kështu mundësinë e regjistrimit të të gjithë atyre fëmijëve të mbetur të paregjistruar të lindur nga prindër shqiptarë.

Problematika kemi pasur, gjithashtu, edhe në rastin e kërkesës për fitim shtetësie ose lënie të shtetësisë shqiptare në rastet kur prindërit kanë qenë të divorcuar. Në këtë rast jemi munduar ta lehtësojmë procedurën. Kemi lehtësuar, gjithashtu, procedurat për marrjen e shtetësisë për ata persona që e kanë pasur shtetësinë shqiptare, por e kanë lënë atë dhe dëshirojnë ta rimarrin atë dhe, pse jo, nuk kemi pse t'ua bëjmë të vështirë procedurën pikërisht atyre personave që e kanë pasur një herë shtetësinë shqiptare dhe kanë vendosur ta rimarrin atë.

Gjithashtu, jemi munduar të rrisim disa filtra garancie nisur nga parimi i sigurisë kombëtare, kemi bërë disa parashikime në dispozitat e ligjit në lidhje me rastet kur ne kërkojmë të hiqet shtetësia shqiptare, pa vullnetin e individit, kur e kërkon Ministria e Brendshme, në rast se ka të dhëna që personi është pjesë e organizatave kriminale, terrorizmit.

Është risi në ligj edhe neni 9, pra fitimi i shtetësisë për interesa ekonomike, kulturore, arsimore dhe kombëtare, është parim i njohur, është një nënloj i natyralizimit të fitimit të shtetësisë në mënyrë natyrale. Ky koncept është futur për herë të parë.

Për herë të parë kemi futur konceptin *e jus solis*, të fitimit të shtetësisë me lindje në territor, po them e pjesshme, sepse e kemi futur vetëm për ata fëmijë që nuk kanë shtetësi, kjo në kuadër të përfshirjes së shtetit shqiptar në luftën e fenomenit të pashtetësisë dhe besoj se na bën nder ne si komb dhe si shtet një parashikim i tillë.

Unë vlerësoj që ky projektligj është munduar të mbyllë ato problematika të dala nga ligji i mëparshëm, t'u japë zgjidhje shumë çështjeve dhe besoj se do të jetë një ligj me impakt të mirë te qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Dua të jap konsideratën time për këtë projektligj. Ligji që kemi pasur deri tani daton para 30 vjetësh, madje para se të miratonim edhe Kushtetutën, kështu që, për të qenë korrektë, do të thoshim se vetëm pas kaq vjetësh, pasi kanë kaluar edhe shumë kohë nga ratifikimi i Konventës Europiane për Shtetësinë ne vijmë në përmbajtje të një projektligji, i cili shpreh në mënyrë të qartë detyrimin që kanë organet publike dhe institucionet shtetërore për të respektuar të drejtat themelore të njeriut, të cilat janë të pandashme, të pazëvendësueshme dhe qëndrojnë në themel të çdo rendi juridik. Çështja e shtetësisë ka të bëjë me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Në Kushtetutë në nenin 19 parashikohet që “kushdo që lind, duke pasur edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare e fiton shtetësinë shqiptare”. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara në ligj, por dua të theksoj posaçërisht këtë fjali të këtij neni për të kuptuar që ne sot kemi ardhur në detyrimin për të sjellë një ligj, i cili parashikon të gjitha rastet kur fitohet shtetësia shqiptare ose kur lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, që është një proces që kalon nëpërmjet ushtrimit të një të drejte që ne me Kushtetutë ia kemi njohur Presidentit të Republikës.

Shpresoj që gjatë kohës të arrijmë të kuptojmë që procesi i punës i hartimit të këtij projektligji ka pasur gjithë *background-in* e nevojshëm të **kazuistikës**, e cila do të mund ta bënte atë me një përmbajtje që t'i përshtat rrethanave të kohës.

Fjalën e ka zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit!

Është kënaqësi dhe nuk është e shpeshtë që ne në biseda sa i përket projektligjeve të ndryshme të kemi këtë nivel të lartë përfaqësimi nga përfaqësues ndërkombëtarë. Kjo tregon përkushtimin tuaj, por edhe frymën në grup për të sjellë sot një projektligj sa më të përshtatshëm në përputhje me të gjitha konventat dhe atë çfarë kërkon realiteti shqiptar.

Shtetësia është një e drejtë themelore, e cila krijon një identitet, por edhe gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike, ashtu sikurse pashtetësia e vendos individin në një situatë vulnerabël, ku nuk mund të përfitojë nga të drejtat e tij, por edhe mund të ketë ndikime negative.

Migrimi është një fenomen i pranishëm në të gjitha vendet dhe Shqipëria është prekur nga kjo plagë, nga imigracioni dhe migracioni. Shumë vende janë detyruar të ndryshojnë legjislacionin si pasojë e këtij fenomeni dhe besoj se projektligji i sotëm përshtatet edhe me situatën që ka kaluar Shqipëria.

Në fakt, siç u tha edhe nga zonja Felaj, që nga vitit 1998 ky projektligj e ka pasur të nevojshëm ndryshimin. Edhe unë kam qenë pjesë e Ministrisë së Brendshme dhe jam përballur shumë herë me situata, të cilat korniza ligjore nuk i bënte shumë të qarta dhe krijonte shumë probleme, të cilat binin në kurriz të qytetarëve shqiptarë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Duke u ndalur te projektligji, një falënderim ia drejtoj Ministrisë së Brendshme, sepse ky projektligj rregullon shumë nga problemet e hasura dhe përcakton qartë shumë nga parimet dhe rregullat për rifitimin dhe humbjen e shtetësisë.

Është një projektligj dukshëm i harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar dhe i ratifikuar me kuadrin ligjor. Projektligji e ka zgjeruar mënyrën e fitimit të shtetësisë. Në të gjitha nenet e këtij projektligji përcaktohen kritere më të qarta për fitimin e shtetësisë shqiptare, të cilat ndryshojnë në varësi të mënyrës së fitimit dhe të kategorisë së të huajve. Në rastin e fitimit të nënshtetësisë shqiptare janë përcaktuar kritere më të lehtësuara. Kjo vlen për t'u vlerësuar meqenëse personi ka qenë shtetas shqiptar dhe ndaj tij nuk mund të aplikohen kritere të njëjta me shtetasit e huaj, por gjithsesi duhet që të respektohet parimi i mosdiskriminimit.

Projektligji përcakton rregullat dhe rastet e qarta të fitimit të shtetësisë, në rastet kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës ekonomisë dhe sportit, duke autorizuar rregullimin me akt nënligjor, pasi një gjë e tillë ka munguar duke bërë që të mos ndiqet një procedurë e përcaktuar dhe e unifikuar për të gjitha rastet. Në dijeninë time ka pasur raste të shumta, ku ministra të caktuar, brenda kuadrit ligjor, i kanë propozuar Presidentit kërkesa për fitimin e shtetësisë, por kjo ka krijuar një konfuzion dhe moskoordinim të punës.

Gjithashtu, janë parashikuar kushtet për heqje dorë nga shtetësia shqiptare dhe në veçanti për fëmijët, siç është: rregullimi i heqjes dorë nga shtetësia për fëmijët me prindër të divorcuar. Në fakt, ky është një shqetësim, për të cilin edhe grupi i deputetëve “Miq të Fëmijëve” kanë propozuar disa ndryshime ligjore, dhe shpresoj që nga grupet e punës, që ju përmendët, të jetë marrë në konsideratë edhe kërkesa e grupeve të interesit, për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve.

Projektligji parashikon procedurat për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia duke përcaktuar, sikurse e thashë, qartë institucionet përgjegjëse.

Nga ana tjetër është parashikuar heqja e nënshtetësisë shqiptare në rast se shtetasi shqiptar e ka fituar shtetësinë me natyralizim dhe përkrah kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, aktiviteti i të cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare dhe të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë.

Nisur nga fakti që në shumë raste shtetasit që kanë fituar shtetësinë kombëtare me dekret të Presidentit nuk janë regjistruar në gjendjen civile dhe ka sjellë më pas një refuzim për regjistrimin e këtyre shtetasve, në projektligj vlen për t’u theksuar se është parashikuar edhe ky rast, gjithashtu, është parashikuar edhe bërja e betimit brenda 6 muajve nga njoftimi i dekretit për fitimin e shtetësisë shqiptare, në të kundërt ky dekret nuk do të ketë efekt.

Për sa i përket zgjidhjes së çështjes së pashtetësisë, por edhe për të lexuar kriteret e rifitimit të saj, më vjen mirë që kjo çështje është adresuar me detaje në këtë projektligj, është vlerësuar i nevojshëm përcaktimi i një afati për shtetasit shqiptarë që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare për shkak të premtimit të një shtetësie tjetër. Për këtë çështje është planifikuar edhe në dispozitë kalimtare edhe e drejta për të rifituar shtetësinë shqiptare mbi bazën e kërkesave të personave që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare përpara hyrjes në fuqi të këtij projektligji dhe që nuk kanë fituar shtetësinë e premtuar.

Nisur nga rëndësia që ky projektligj ka për qytetarët e huaj, të cilët prej vitesh jetojnë dhe punojnë në Shqipëri, sigurisht, edhe për shqiptarët që jetojnë jashtë, por edhe për fëmijët e lindur jashtë vendit, mendoj se duhet ta miratojmë, por pa dyshim duke u lënë vend edhe diskutimeve.

Në mbyllje të fjalës sime kisha 2 – 3 komente për zëvendësministren.

Zonja Zëvendësministre, ju thatë se këtë projektligj e keni bërë në një proces konsultimi. Unë dua të di se sa i gjerë ka qenë ky konsultim, sepse ka shumë grupe të interesit, sidomos për pjesën e fëmijëve, të cilat kanë ngritur herë pas here shqetësime në lidhje me problematikat që kanë sidomos fëmijët e lindur jashtështetit.

Nga ana tjetër mendoj se për shkak edhe të përfshirjes së shumë institucioneve në lidhje me këtë ligj, ndoshta duhet të jetë më e qartë pjesa se si do të funksionojë regjistrimi i shtetasve shqiptarë. Pra, mbase ka ardhur koha të bëjmë një databaze më special, të cilin ndoshta ju e keni dhe kjo do të jetë pjesë e diskutimeve, por po sjell në vëmendje që nuk pashë diçka specifike në lidhje me një databaze apo regjistrimin, sepse ka pasur probleme në lidhje me këtë.

Ju përmendet Italinë, por ka shumë vende të tjera me opsione të ndryshme të funksionimit të ligjit. Unë di që në shumë vende, edhe për shkak të investimeve, ka një liberalizim të dhënies së shtetësisë, pra për shtetas që duan të investojnë, sigurisht, konform të gjithë filtrit që duhet të kalojnë për sa i përket integritetit të tyre. Mbase kjo ia vlen të diskutohet. Pra, si e keni marrë në konsideratë këtë në raport me ligje të ngjashme, për shembull, kujtoj ligjin e Malit të Zi e të tjerë?

Gjithsesi, këto janë komente të vogla krahasuar me produktin dhe me atë kontribut të shtuar që do të sjellë ky ligj për shtetësinë, i cili do të jetë edhe një produkt i monitoruar, për ta parë më konkretisht se si ky ligj do të jetë në praktikë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea, për analizën e detajuar të projektligjit! Por përpara se t’ia jap fjalën zonjës Voda, për pikat që ju ngritët, më lejoni që të respektoj më të ftuarit në Komisionin e Sigurisë, përfaqësuesit e komisionarit të lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe përfaqësuesit e UNHCR-së. Meqenëse kanë bërë edhe disa komente për projektligjin, të cilat i janë përcjellë këtij komisioni, dua që zoti Zapata dhe zoti Brian të shprehin komentet e tyre për këtë projektligj. E theksoj edhe një herë se qëllimi ynë është i përbashkët me shqetësimin tuaj, që ligji të reflektojë më mirë problemet e personave pashtetësi dhe situata e këtyre personave të vijë duke u reduktuar edhe në Shqipëri. Pra, shqetësime të ngjashme me të tuajat kemi edhe ne. Mendoj se fjala e zonjës Gjebrea na jep të drejtën që t’i kërkojmë mendim për projektin

edhe UNICEF-it, nëse situata e fëmijëve që kanë njërin nga prindërit shqiptar, duhet rregulluar deri në fund.

Fjala është për ju.

Faleminderit!

Brian Williams – Mirëmëngjesi!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Unë jam Brian Williams, kordinator rezident i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

Zoti Zapata, kolegu im, do të japë komente më të detajuara në lidhje me këtë ligj, por unë jam këtu për të dëshmuar për dy çështje multilaterale që lidhen me zhvillimin e vendit. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, e cila është e parashikuar brenda këtij ligji provon që qeveria shqiptare, pra Shqipëria po plotëson kushtet në lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në agjendën e saj deri në vitin 2030.

Siç mund ta dini, njëra prej motive kryesore të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm është ajo që të mos lihet kush pas. Në kuadër të këtij ligji, i cili mbron të drejtat e njeriut, ky kusht është plotësisht i vendosur dhe i përfshirë.

Së dyti, dua të përforcoj idenë se Shqipëria po bën përpjekjet e saj në aspektin multilateral për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Shqipëria, si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, merr pjesë në Rishikimin Universal Periodik, e cila zhvillohet për të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara çdo katër vjet. Ky proces në Shqipëri ka qenë mjaft i suksesshëm dhe ka ndodhur në fillim të këtij viti. Rishikimi Periodik Universal, si proces ka bërë më shumë se 150 rekomandime për Shqipërinë, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe Shqipëria është angazhuar për plotësimin e këtyre vërejtjeve dhe rekomandimeve. Mes tyre mund të përmendim rekomandimet që janë bërë për refugjatët, personat pa shtetësi, për minoritetet dhe për komunitetet që janë në rrezik dhe Shqipëria i ka pranuar të gjitha këto rekomandime.

UNHCR-ja është një agjenci lider në lidhje me këtë proces dhe përfshirja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut është pjesë e të gjitha agjencive simotra të Kombeve të Bashkuara, gjithashtu dhe agjencive që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve.

Faleminderit, që na ftuat në një takim të tillë që ne të kemi mundësi të japim kontributin tonë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Zapata.

Pablo Zapata – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, ju i keni komentet tona, që kemi bërë në mënyrë zyrtare nga agjencia, jo vetëm nga zyra jonë në Shqipëri, por janë konsultuar edhe me përfaqësuesit e UNHCR-së. Java që ka kaluar, ka qenë një javë interesante për çështjet e pashtetësisë. Në kontekstin e komitetit ekzekutiv të UNHCR-së, komisioneri i lartë, zoti Grandi ka ftuar vendet e botës, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare për të diskutuar për dy ditë për çështjet e pashtetësisë.

Shqipëria është përfaqësuar nga ana e zonjës Voda dhe është një nga 55 vendet e botës ose shteti që ka bërë disa premtime konkrete, Shqipëria ka bërë tri të tilla. Zonja Voda është këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegët e mi dhe një delegacion tjetër kanë qenë shumë të impresionuar me progresin që ka bërë Shqipëria, me punën që ka avancuar në dy vjetët e fundit dhe për angazhimet konkrete. Pra, nuk ka pasur vetëm fjalë, por edhe çështje konkrete. Njëra prej tyre lidhet me ligjin në fjalë, i cili është një ligj i mirë nga ana e të drejtave ndërkombëtare. UNHCR-ja e vlerëson si një ligj shumë komplet, por është në proces të përmirësimit të ligjit të vitit 1998 dhe ka më shumë garanci nga ana e pashtetësisë.

Viti i kaluar ka qenë shumë interesant për ne me autoritetet qeveritare dhe me Kuvendin e Shqipërisë. Në muajin qershor të vitit të kaluar kemi publikuar së bashku një raport për rrezikun e pashtetësisë në Shqipëri. Së bashku me qeverinë, me Kuvendin dhe me organizatat joqeveritare kemi evidentuar disa raste kur fëmijët shqiptarë nuk e marrin ose hasin probleme për të konfirmuar shtetësinë shqiptare. Pastaj parlamenti, Kryetari i Kuvendit dhe grupi “Miqtë e fëmijëve” i kanë marrë rekomandimet nga ana ligjore shumë shpejt dhe vërtet ne kemi qenë pak, nuk di ta shpreh në shqip nga ana formale, por le të themi, të habitur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të surprizuar për amendamentet që ju keni bërë në Kuvend në ligjin “Për gjendjen civile”. Tani kemi një ligj që i mbron më mirë fëmijët dhe që i ka lehtësuar procedurat administrative edhe në gjykatë, sidomos për dy kategori fëmijësh, ata që kanë lindur jashtë Shqipërisë dhe fëmijët e komuniteteve egjiptiane dhe rome.

Urime për punën e bërë në këtë drejtim!

Tani jemi në fazën e akteve nënligjore, të cilat kanë qenë aprovuar dhe publikuar nga janari deri në mars të këtij viti, ndërkohë që jemi në proces zbatimi.

Vijmë te ligji “Për shtetësinë shqiptare”. Tani për tani kemi vetëm katër ose pesë komente, të cilat nuk janë thelbësore, por për të përmirësuar ligjin që ju keni bërë nga ana e qeverisë. Kemi qenë në kontakt, siç e tha zonja Voda, në procesin e parë dhe kemi bërë një analizë më të detajuar për ta përmirësuar. Rekomandimet nuk u përkasin politikave publike, por janë ligjore.

Kemi katër konventat e Kombeve të Bashkuara, që kanë standarde shumë të qarta, dhe projektligjin. Për ne Shqipëria, pas periudhës së demokracisë, ka qenë një vend që është angazhuar konkretisht për të drejtat e njeriut. Nuk është një gjë për diskutim, por vetëm për përmirësimet këtu.

I pari është i qartë për ne. Është përkufizimi i pashtetësisë. Është dhënë qartë përkufizimi i pashtetësisë, se kush është një person pa shtetësi. Ka një nen shumë të qartë në konventën nr. 10054. Ky vërtet nuk do shumë shpjegim, sepse është më shumë një rregullim ligjor.

Komenti ynë i dytë lidhet me ligjin “Për gjendjen civile”, që ju e keni amenduar vitin e kaluar dhe ka bërë shumë punë. Tani kemi dy raste pak ekstreme. Mund të kemi një situatë kur një fëmijë i lindur ose i ndodhur në Shqipëri mund të jetë në rrezik pashtetësie. E kemi shpjeguar në komentin tonë se cilat janë standardet ndërkombëtare dhe çfarë propozimi kemi për ligjin për shtetësinë. Me thënë të vërtetën, në një rast është vetëm një fjalë, që është e ngjashme, por ne jemi në një situatë kur fjalët vërtet janë të rëndësishme.

Në Kombet e Bashkuara nuk e kemi fjalën “transpozim”, por është si një transpozim në konventën nr. 1961 për të mbyllur çështjet e fundit ose mundësinë e fundit të pashtetësisë. Ju i keni të detajuara komentet tona. Nuk kemi të tjera.

Edhe komenti i katërt dhe i pestë kanë të bëjnë me natyralizimin. Ka dy raste: natyralizimi i refugjatit dhe i personave pa shtetësi. Në këtë rast rekomandimi ynë është sipas konventës nr. 54 dhe konventës nr. 51 “Për statusin e refugjatit” për të krahasuar afatet kohore të rezidencës në Shqipëri me të huajt e tjerë, nga ana e refugjatëve dhe personave pa shtetësi.

Atëherë, në qoftë se afati kryesor ose normal është pesë ose shtatë vjet, qoftë refugjatët, qoftë personat pa shtetësi e përfitojnë njëlloj standardin.

Edhe në rastin e personave pa shtetësi ka një limit të vogël në projektligj, që për personat pa shtetësi që kanë lindur në Shqipëri, ne propozojmë të jetë edhe për personat pa shtetësi që kanë

rezidencë në Shqipëri. Ky është kuptimi më shumë si lindje ose jo lindje për personat pa shtetësi që janë rezidentë në Shqipëri.

Kjo ishte një përmbledhjeve e komenteve tona, ndërkohë që ju i keni më të detajuara.

Për çështjet e pashtetësisë ne punojmë ngushtë me Unionin Parlamentar Ndërkombëtar dhe kemi botuar dy *handbooks* për deputetët. Për këtë çështje ne kemi me vete një kopje në shqip, që pastaj mund ta depozitojmë pranë sekretarisë së komisionit, që edhe ju të keni disa ide.

Faleminderit!

Më vjen keq për gjuhën shqipe që nuk është as mirë, as siç duhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Përkundrazi, besoj se kam edhe mbështetjen e kolegëve që ju na nderuat duke folur në gjuhën shqipe. Kështu që faleminderit edhe për këtë aspekt, edhe për komentet tuaja për projektligjin, që, në fakt, në materialin që na keni përcjellë janë të argumentuara! Besoj se gjatë diskutimit nën për nën do të kemi rastin që të gjejmë gjuhën e përbashkët për të rënë dakord me ju, me Ministrinë e Brendshme dhe, natyrisht, me qëndrimin që do të kenë deputetët e këtij komisioni parlamentar.

Besoj se deri këtu e kemi të qartë se çështja e shtetësisë nuk është thjesht një çështje përkatësie, as identiteti, por, mbi të gjitha, është edhe një çështje nevojë, sepse me shtetësinë janë të lidhura edhe të gjitha të drejtat e tjera dhe liritë themelore të njeriut. Prandaj është shumë e rëndësishme që ligji të krijojë aksesin, i cili të mos jetë i vështirë, por as edhe burokratik. Madje, besoj se praktika e tridhjetë vjetëve duhet të na ndihmojë të kuptojmë se si mund t'i rregullojmë çështjet që janë ndeshur deri sot dhe që zonjat Voda dhe Gjebrea, por edhe përfaqësuesit e UNHCR-së i cilësuan gjatë fjalës së tyre.

Unë jam e detyruar të hap debatin për kolegët. Kështu që, kushdo nga kolegët, i cili ka pyetje për të sqaruar, tani mund të shprehet.

Fjalën e ka zonja Duka dhe pastaj zonja Dhima.

Elena Xhina (Duka) – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, e falënderoj zëvendësministren për parashtrimin e projektligjit, pasi tashmë ishte koha të vinte një projektligj i tillë, sepse problematikat kanë qenë të mbartura ndër vite!

Gjithashtu, falënderoj përfaqësuesit ndërkombëtarë për kontributin e dhënë, pasi eksperiencia ndërkombëtare është shumë e vlefshme në këto raste.

Pyetja ime ka të bëjë me faktin se, siç u tha këtu më parë, ligji “Për gjendjen civile”, i cili vitin e kaluar pësoi ndryshime, hodhi hapin kryesor për problemin e fëmijëve të lindur jashtë shtetit. Meqenëse mendoj se ky ligj e afekton njëfarësoj ligjin “Për gjendjen civile”, a mendoni se do të lindte nevoja për ndryshime në ligjin aktual “Për gjendjen civile” ose në ligje të tjera që përmendin në dispozitat e tyre çështjet e shtetësisë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Duka!

Zonja Voda, fjala është për ju.

Rovena Voda – Faleminderit!

Pyetja është e qartë, por mendoj se jemi munduar që me parashikimet, që kemi bërë këtë, të mos biem ndesh me ndryshimet e reja në ligjin “Për gjendjen civile”. Kështu që mendoj se, të paktën nga një analizë paraprake që grupi i punës ka bërë, nuk ka parë se ka diskordancë ndërmjet këtyre parashikimeve dhe ndryshimeve të fundit.

Mendoj se për momentin nuk kemi një përplasje të tillë. Janë dispozita secila, pra janë dy ligje specifike në funksion të tyre, ndoshta edhe që mund ta plotësojnë njëri-tjetrin, por që nuk bien ndesh.

Më lejoni, gjithashtu, të ndaj me ju lajmin e mirë, nuk e di nëse zoti Zapata ka dijeni, që të gjitha aktet nënligjore, në fakt, që kanë qenë detyrim i Ministrisë së Brendshme, janë të hartuara dhe të miratuara. Kështu që tashmë kuadri i plotë i ndryshimeve në ligjin “Për gjendjen civile” është gati për t’u implementuar. Pra, nuk ka përplasje, të paktën aktualisht, me dispozitat që ne kemi këtu.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonjës Zëvendësministre për prezantimin dhe, njëkohësisht, përfaqësuesve të UNHCR-së, të cilët janë prezentë sot me komentet dhe sugjerimet e tyre!

Më vjen mirë që ne po diskutojmë sot një projektligj shumë të rëndësishëm dhe tejet të domosdoshëm, pasi ai ka evidentuar të gjitha problemet dhe problematikat që janë hasur ndër vite.

Unë do të doja të bëja dy pyetje.

E para, sa do të jetë koha, nga momenti kur një qytetar drejtohet për heqjen e shtetësisë ose për marrjen e saj?

E dyta, në relacionin që na keni sjellë, thoni se ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, por do të ketë efekte financiare pozitive. Sa do të jenë këto efekte dhe ku do të përdoren të ardhurat që do të krijohen nga zbatimi i këtij ligji?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima, për pyetjet tuaja!

Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Për sa u përket afateve, janë afate të përcaktuara në ligj. Pra janë afatet që do të duhet të marrë verifikimi në Policinë e Shtetit, në Ministrinë e Brendshme, të cilat në total tashmë, nuk e di, por do të shkojnë rreth nëntë muaj, nuk po i ndaj më vete. Pra, deri me daljen e dekretit, do të jetë një periudhë nëntëmuajore për fitimin e shtetësisë. Besoj se e njëjta gjë do të jetë edhe për heqjen e shtetësisë, pasi kalon në të njëjtin... Bëhet një verifikim nga organet. Ndoshta mund të jetë disi më e shkurtër si kohë, por, gjithsesi, periudha shkon përafërsisht deri në nëntë muaj, që unë besoj se është një periudhë normale për t'i bërë një verifikim figurës së pastërtisë, po themi, të personit në lidhje me sigurinë kombëtare për sa i përket rritimit të shtetësisë, më lejoni që ta them: në fillim ishim të një ideje që t'i vinim një kohë 2 vjet personit, i cili do të rifitonte Shqipërinë, që të qëndronte këtu, por, në fakt, ne e kemi hequr fare këtë barrierë. Pra, personi që, kërkon të rifitojë shtetësinë shqiptare, vjen direkt pa qenë nevoja të provojë që ka qëndruar rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë. Besoj se kjo është një lehtësi shumë e madhe, sepse në pozicionin e zëvendësministres së Brendshme, që mbuloj edhe pjesën e shtetësisë, ashtu si kolegja ime Gjebrea, kam vënë re se ka shumë shqiptarë që duan ta rimarrin atë, pra, edhe pse e kanë lënë, e rimarrin, por kjo barriera e të kthyerit, duke e barazuar me një person që nuk ka pasur kurrë, që të ketë periudhën e rezidencës, e bënte si të thuash të lodhshme, duke e futur në një kalvar të gjatë. Tashmë ne këtë barrierë e kemi hequr dhe kjo lehtëson goxha.

Për sa u përket efekteve në buxhetin e shtetit, është e vërtetë, që projektligji nuk sjell ndonjë barrë në buxhetin e shtetit, por më vonë ne themi se patjetër do të ketë impakt pozitiv. Pse? Sepse, ashtu siç e thashë në nenin 9 të projektligjit ne për herë të parë kemi parashikuar një nënloj të veçantë të fitimit të shtetësisë me natyralizim, siç është "*jus soli*", pra edhe të fitimit nëpërmjet investimeve, me interes ekonomik në bazë të programeve të veçanta. Pra, flasim për investime serioze jo thjesht duke e lidhur çështjen e fitimit të shtetësisë me blerjen e një pasurie të patundshme, apo ku di unë, por flasim për programe serioze të mëdha investimi, ku, sigurisht, detajimi do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kriteret për skanimin apo vetingun,

nëse më lejoni ta përdor këtë fjalë që tashmë është bërë e modës, e kompanisë apo të personit që do të investojë në Republikën e Shqipërisë. Kështu që, duke u nisur pikërisht nga parashikimet e këtij neni, mendojmë se në rastet kur do ta japim, sigurisht impakti do të jetë pozitiv në ekonomi, por është shumë herët për ta parashikuar dhe për të dhënë një shifër konkrete.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Harusha!

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Voda, kam një pyetje: sa persona në Republikën e Shqipërisë nuk e kanë nënshtetësinë shqiptare? A keni ndonjë statistikë? Sa persona nuk e kanë shtetësinë shqiptare?

Rovena Voda – Faleminderit!

Në fakt, shifrën e kam të freskët, sepse kam qenë tek takimi i nivelit të lartë me Komisionerin e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Nga një vlerësim i fundit që ne kishim bërë për personat, që nuk kanë shtetësinë shqiptare ose që nuk kanë shtetësi tjetër, ka qenë rreth 1035 persona, por nga vlerësimi, që ne bëmë më pas dhe me lehtësimin e dispozitave të ligjit “Për gjendjen civile”, duke parë kërkesat që erdhën për regjistrim, ky numër fatkeqësisht është shumë. Pra, janë më shumë se 1035, mund të jetë edhe dyfish i këtij numri. Të paktën flas për periudhën para 6 muajsh apo 1 viti. Gati dyfishi i këtij numri mund të ishte numri i personave pa shtetësi në territorin Republikës së Shqipërisë. Duke pasur parasysh që Shqipëria është një vend i vogël, sigurisht që ky nuk është një numër i vogël, është një numër i konsiderueshëm dhe për këtë arsye ne morëm dhe angazhimin për të luftuar këtë fenomen.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha – Këta 1035 persona janë shtetas shqiptarë apo janë edhe shtetas të huaj ?

Ermonela Felaj – Zonja Voda, ideja është që të na bëni një përcaktim se sa persona pa shtetësi janë në territorin e Shqipërisë. A ka një vlerësim paraprak? Sa shtetas shqiptarë që i kanë kaluar 18 vjeç dhe nuk janë regjistruar? A mund të kemi një vlerësim? Megjithëse duket e vështirë, sepse bëhet fjalë për lindje jashtë vendit dhe ndodhsha nuk janë regjistruar fare këtu në Shqipëri. Kjo do të shikohet, pasi ligji të hyjë në fuqi dhe nga kërkesat që do të kemi. Sa vlerësohet të jetë numri i atyre personave, që janë rezidentë në Shqipëri dhe, sipas përmbajtjes së projektligjit që ju keni sjellë, vijnë në kushtet për të pëfituar të drejtën e shtetësisë shqiptare? Pak a shumë për secilën kategori që ju shpreheni në ligj, a ka një vlerësim paraprak? Nëse janë ato shifra, do të na interesonin t’i dinim.

Rovena Voda – Atëherë, duke i qëndruar shifrës që unë thashë, kategoria kryesore, pra mbi 90% e këtij fokusi, e këtij grupi janë kryesisht shtetas shqiptarë pa shtetësi, pra kryesisht fëmijë shqiptarë, romë dhe egjiptianë. Pra, kategoritë vulnerabël, fëmijët romë dhe egjiptianë. Kjo është kategoria. Ndërsa persona pa shtetësi, por të huaj, nuk kemi, ose mund të jetë ndonjë shifër e papërfillshme. Po këto kanë qenë dy kategoritë. Pra, vetë fëmijët tanë, fëmijë të lindur nga prindër shqiptarë, por të paregjistruar, dhe fëmijët romë e egjiptianë. Këto kanë qenë dy kategoritë vulnerabël.

Ermonela Felaj – Besoj se përgjigja ishte e qartë.

Fjalën e ka zonja Gjebrea dhe më pas zoti Maliqi.

Elona Gjebrea – Në fakt, debati në lidhje me statistikat ia vlen dhe, ndoshta, ju në argumentimin e ligjit të keni disa statistika, të cilat na ndihmojnë edhe ne. Nga informacioni që kam, numri është më i lartë, në qoftë se i referohet Institutit të Statistikave censusi i popullsisë dhe i banesave, por, sigurisht, ndahet për pa shtetësi dhe për pashtetësi për arsye të ndryshme. Ndoshta te e përgjithshmja pa shtetësi, që unë di se janë rreth 7 mijë, futen edhe të huajt. Gjithsesi e rëndësishme është që ne të kemi disa statistika të argumentuara; nuk pashë shumë statistika në rend kronologjik të shkruara tek argumentimi që i bëtë projektligjit. Gjithsesi fakti që keni këtë projektligj tregon se do t'i merrni në konsideratë edhe ndryshimet ligjore që do ta ndihmojnë për të zbutur këtë hallkë. Sikurse e tha edhe kryetarja, për ta forcuar, komentet e UNHCR-së janë komente, të cilat ia vlen të diskutohen në diskutimin nën për nen dhe të gjendet një kompromis.

Nga ana tjetër, kam vetëm një pyetje. Ju thatë se do të bëhet me VKM pjesa për marrjen e nënshtetësisë me natyralizim.

Nga ana tjetër, pjesa për mbështetjen e personave me investime të konsiderueshme. Në cilin nen është e përcaktuar tamam?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Urdhëroni, zonja Voda!

Rovena Voda – Ndoshta do t'i jap të drejtë zonjës Gjebrea për sa i përket pjesës së përfshirjes së statistikave në relacion. Pavarësisht se e gjithë kjo iniciativë për të luftuar fenomenin e pa shtetësisë ka ardhur në saj të këtij vlerësimi paraprak që ne kishim bërë me ndihmën e UNHCR-së, të organizatave të ndryshme, por edhe me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shtetit për Diasporën, pra qeverinë shqiptare dhe këto organizatat, që ne të kuptonim rëndësinë e

kësaj gjëje, që më vonë të mos arrinim të përballeshim me një fenomen shqetësues, sigurisht, kemi një pasur indikator, ndoshta mund të ishte shprehur më qartë, por e sqarova.

Për sa i përket pjesës së VKM-së në nenin 9, që besoj se e referova, patjetër që duhet të jetë parashikuar edhe autorizimi për nxjerrjen e akteve nënligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikat 2: “Procedura e kryerjes së verifikimeve, kontrolleve nga institucionet përgjegjëse, me bashkëpropozimin e ministrave përgjegjës, sipas fushës tyre të përgjegjësisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Pika 3: “Kriteret e përfitimit të shtetësisë, programet e veçanta që zbatohen, rastet e përcaktuara në pikën 1, si dhe procedurat e verifikimit miratohen rast pas rasti me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit dhe ministrave përgjegjës, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë”. Pra, në lidhje me këtë, patjetër që ne në ligj kemi garantuar autorizimin për nxjerrjen e një akti nënligjor.

Elona Gjebrea – Po insisto, sepse nuk del i qartë fakti se këtu bëhet fjalë për një gjë të re. Në qoftë se do të lexojmë relacionin, pra se cilat janë objektivat që synohen nëpërmjet miratimit të kësaj politike, i dyti është zhvillimi ekonomisë, dhënia e shtetësisë shqiptare të huajve për investimet strategjike e të tjera. Këtu nuk del fare e shkruar kjo gjë; por vetëm një fjalë e përgjithshme “ekonomisë”. Kam përshtypjen se kështu ka qenë si ligj, pra ndoshta ju e keni më të qartë në momentin kur do të bëhen aktet nënligjore. Për shkak ndryshimit dhe rëndësisë që ka ky ligj, ashtu sikurse ju e shprehët në relacion, të ketë një fjali më shumë për të kuptuar se ky është një ligj që sjell një vlerë të shtuar për sa u përket personave, të cilët do të investojnë në ekonomi. Megjithatë, unë nuk jam juriste dhe në këtë pikë nuk duhet të insisto shumë; thjesht ma vret syrin, sepse thuhet si një gjë e re, por nuk shihet këtu.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

A keni ndonjë koment tjetër, zonja Voda?

Rovena Voda – Mendoj se nuk ka nevojë për shumë komente për të kuptuar, që, nëse ne do të lejojmë fitimin e shtetësisë nëpërmjet investimit, sigurisht që kjo do të sjellë një impakt pozitiv, por jemi munduar të jemi pak diskretë, zonja Gjebrea, sepse edhe në formulimin e këtij neni, por edhe kur të hartojmë aktet nënligjore unë ju siguroj juve si ligjvënës se ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me delegacionin europian në Shqipëri dhe me Komisionin Europian, sepse, në

fakt, shumë vende që e kanë këtë lloj fitimi të shtetësisë nëpërmjet investimit, që e kanë futur para nesh, pra para Republikës së Shqipërisë në legjislacion, vende fqinje, por qoftë edhe vende të tjera në Europë, janë bërë shqetësim për Bashkimin European për faktin se kujt ia japin shtetësinë, pra kush janë këta individë që e marrin dhe kërkojnë të investojnë. Kjo për arsye nga më të ndryshmet. Kjo dispozitë, pra fitimi i shtetësisë shqiptare nëpërmjet investimit të një personi që vjen nga një vend i tretë duke marrë pasaportën shqiptare dhe duke lëvizur lirshëm në BE, është e rëndësishme, sepse të mos harrojmë një fakt, Shqipëria ka detyrime konkrete lidhur me respektimin e lëvizjes së lirë në zonën shengen. Nisur nga kjo ne jemi në një konsultim të ngushtë. Komisioni European na ka kërkuar tekstin e përkthyer në anglisht të ligjit, të relacionit, dhe ua kemi dërguar. Ne prisnim komentet e tyre, ende nuk na i kanë sjellë, shpresoj t'i kemi brenda kësaj jave, por në konsultim të ngushtë do të jemi me ta edhe kur të hartojmë VKM-të, sepse patjetër që do të na duhet të vëmë kritere shumë të rrepta në mënyrë që të mos ketë hije dyshimi për investitorë të huaj që mund të vijnë në Shqipëri dhe mund të kenë qëllim pastrimin e parave.

Ermonela Felaj – Nuk e di nëse fjala juaj përkon edhe me një rast që e kemi dëgjuar nëpërmjet medias, që para disa vitesh aktori i njohur Depardie la shtetësinë franceze në momentin që u rritën taksat dhe mori shtetësinë ruse. Një rast të tillë a do të mund ta lejonte ligji shqiptar?

Rovena Voda- Ligji fokusohet te programet e veçanta, pra ne kemi thënë programe edhe për rastin e interesave kulturore, sportive, arsimore, pra programe, jo thjesht kontribute individuale, sepse nuk besoj se Gerard Depardie vajti atje me një program ekonomik ose arsimor me sa di unë, ai thjesht la shtetësinë dhe aplikoi për të marrë shtetësinë për taksën.

Ermonela Felaj - Ai e la shtetësinë franceze dhe mori shtetësinë ruse, si reagim ndaj asaj që ndodhi në Francë për sistemin fiskal. Nëse do të kishim një situatë të tillë në Shqipëri, ligji shqiptar a do ta lejonte?

Rovena Voda- Ne do të respektojmë kriteret që vendos ligji ynë, do të thotë, nëse ai vjen me një program investimi, do t'u nënshtrohet kriterëve që do të parashikojë programi i investimit, vendimi i qeverisë. Nëse nuk i nënshtrohet kësaj gjëje, atëherë ai do t'u nënshtrohet kriterëve të një natyralizmi, pra do të duhet të qëndrojë 7 vjet, të ketë leje qëndrimi të përhershme e të tjera.

Ermonela Felaj– Po, zoti Maliqi.

Lefter Maliqi – Faleminderit!

Falënderoj përfaqësuesit e UNHCR-së për këtë projektligj që ka një rëndësi të veçantë për situatën në të cilën jemi, për lehtësime të mëdha për marrjen e shtetësisë, sepse, siç e dimë,

edhe nga raporte ndërkombëtare kemi një shpopullim të vendit, ulje të ndjeshme të lindshmërisë për shkak të krizës së rëndë ekonomike, politike në vend.

Nuk do të futem në statistika, sepse janë nga janari deri tani janë 14 mijë shqiptarë që kërkojnë azil, duke zënë vendin e parë në botë, më shumë se Afganistani dhe Iraku. Nuk po futem as në regjistrimin e gjendjes civile, sepse ekzistojmë 5 milionë banorë, por që jetojnë në Shqipëri nuk janë as 2 milionë.

Megjithatë, ky ligj është i një rëndësie të veçantë. Dua të bëj një pyetje, meqenëse kontributi juaj është shumë i ndjeshëm dhe i madh. Kjo pyetje, mund të jetë me përgjigjen nga ju, por edhe nga zëvendësministrja. Në dijeninë time të plotë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli, por edhe në vendet e Bashkimit Europian, se këtu u tha se mjafton që të jetë një shtetas shqiptar, që të përfitojë fëmija nënshtetësinë, shtetasit mund të jenë të huaj, por, kur lind fëmija, regjistrohet dhe merr nënshtetësinë, e atij shteti. Pse është ky dallim këtu dhe a mund të ketë ndonjë korrigjim në të ardhmen?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Në rregull, besoj se është e qartë pyetja e zotit Maliqi për ju, zonja Voda.

Rovena Voda – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, unë e ceka që në fillim të fjalës sime që ligji për shtetësinë është një ligj që i përket legjislacionit të brendshëm, pra nuk është një ligj që synon përafrimin *acquis* me legjislacione të tjera. Sigurisht, si vend europian që synojmë të futemi në BE patjetër që jemi qasur më shumë, pra jemi afruar më shumë me legjislacionin e vendeve europiane, kryesisht me legjislacionin atë italian, atë kroat, atë slloven apo edhe atë gjerman. Mjafton të them që me lindjen në territor, pra fitimin e shtetësisë me lindjen në territor, “*jus soli*”-in e kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por më lejoni të them që nuk kanë “*jus sanguinis*”, pra vendet që kanë mënyrë të fitimit të shtetësisë të pastër nëpërmjet një mënyre, shpeshherë zgjedhin të kenë një mënyrë të fitimit të shtetësisë, duke zgjedhur ndërmjet mënyrave të ndryshme.

SHBA-ja ka zgjedhur “*jus soli*” dhe nuk njeh “*jus sanguinis*”, shteti italian njeh “*jus sanguinis*, por nuk njeh “*jus soli*” . Po kështu edhe shtete të tjera të BE-së. Megjithatë, unë e siguroj zotin Maliqi dhe të gjithë deputetët këtu, për të na bërë nder ne shtet si shtet, e them edhe një herë si komb shqiptar, që njihemi për traditat tona si një popull mikpritës, dashur, qoftë edhe me të huajt, ne kemi parashikuar “*jus soli*”-in të pjesshëm për të luftuar fenomenin e pa shtetësisë për atë fëmijë të lindur dhe të gjetur pashtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, si një

kategori vulnerabël, të cilët automatikisht duhet ta marrin atë. Kjo është përgjigjja ime dhe besoj se është e bazuar edhe në praktikën ndërkombëtare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha - Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Voda, kam një pyetje konkrete: kur një shtetas shqiptar është martuar me një shtetase të huaj, si procedohet, pasi kam një rast në zonën time. Domethënë, një shtetas shqiptar është martuar me një shtetase ruse dhe ka shumë vite që nuk e merr ende: kanë bërë edhe 2 fëmijë, dhe ende nuk e ka marr nënshtetësinë shqiptare. Çfarë procedurash duhen? Sa zgjat koha e marrjes së saj?

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Voda!

Rovena Voda – Në fakt, është e çuditshme, sepse ligji që është në fuqi, pra ligji i vitit '98, e parashikon fitimin e shtetësisë, neni 10, ku thuhet: “I huaji që është martuar me një shtetas shqiptar prej jo më pak se 3 vjet është (ndërkohë dhe ju më thoni që kanë edhe dy fëmijë dhe besoj se i kanë 3 vjet) në rast se dëshiron, mund ta përfitojë nënshtetësinë shqiptare me natyralizim”. Pra, duhet të përmbushë afatet e qëndrimit në territor që parashikon ligji dhe, në qoftë se nuk plotëson kushtet e tjera, në këtë rast i huaj duhet të ketë banuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën 1 vit. Pra, në qoftë se një vit pa ndërprerje jeton, punon dhe banon, ajo e merr direkt. Kështu që duhet të jetë aktive, të bëjë kërkesën dhe më pas patjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vijë dhe të më kontaktojë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolegë, për të gjitha pyetjet dhe ndërhyrjet tuaja. Ashtu siç e thamë, ky ishte vetëm prezantimi i parë i ligjit, në vijim ne do të kujdesemi që të kemi edhe opinione të tjera, si opinioni i Komisionit Europin, siç e përmendi edhe zonja Voda. Më 14 nëntor është fiksuar në kalendarin e Kuvendit që ky ligj të kalojë në parlamentin e Shqipërisë. Kështu që do të kemi kohë që relatorja dhe zonja Voda të mbledhin opinionet dhe të arrijnë në një qëndrim të përbashkët, i cili t’i sugjerohet komisionit në vijim.

Kush është dakord me miratimin në parim për projektligjin “Për shtetësinë shqiptare”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projekt.

Faleminderit të gjithë të ftuarve për prezencën sot në Komisionin e Sigurisë!

Ne do të vijojmë në ditët e tjera dhe do t'ju njoftojmë paraprakisht se kur komisioni do të mbledhet për të filluar diskutimin nën për nën të këtij projekti.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA